



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:276149

Datë: 15.05.2024

Numri i dokumentit: 05689592

KF.nr.500/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “B.I Term” sh.p.k, me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” sh.p.k, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti rivlerësim i mallit, vlera e kontestit 27,484.91 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës së paditur Xhafer Krasniqi, e në mungesë të palës paditëse, me datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “B.I Term” sh.p.k, me seli në Ferizaj, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.01.3.2.2/18835; 19106; 19642; 20418; 20165 i datës 27.10.2021, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësi “B.I Term” sh.p.k, me seli në Ferizaj, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 08.12.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.01.3.2.2/18835; 19106; 19642; 20418; 20165 të datës 27.10.2021 të të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me arsyetim se në momentin e zhdoganimit të mallit kemi prezantuar të gjitha dokumentet në origjinal, ashtu siç e parasheh Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Tutje ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror nuk i ka vlerësuar drejtë provat e prezantuara në Deklaratën Unike Doganore në vështrim të nenit 33 të KDA-së, të cilat kërkohen në vështrim të nenit 123 të UA

nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, ngase të gjitha janë të harmonizuara në kuptim të vlerës. Po ashtu, ka theksuar se në rastin konkret nuk është dashtë që lënda të rivlerësohet sipas metodës së 6 (gjashtë) neni 35 i KDA-së, pa kaluar në metoda paraprake dhe pa i arsyetuar ato veç e veç, pasi që një vlerësim i tillë është në kundërshtim me metodat e vlerësimit sipas nenit 33 dhe 35 të KDA-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit për anulimin e aktvendimit nr.01.3.2.2/18835; 19106; 19642; 20418; 20165 të datës 27.10.2021, dhe të obligohet e paditura Dogana e Kosovës që ti kthejë mjetet e paguara më tepër në shumë prej 27,484.91 €, me interes bankar nga dita e ushtrimit të padisë, si dhe ti paguaj shpenzimet e gjyqësore në lidhje me këtë kontest gjyqësor. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor të datës 02.05.2024, përfaqësuesja e autorizuar e palës paditëse nuk ka prezantuar, edhe pse e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt ku nga fletë-kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet se ftesën për këtë seancë e ka pranuar me datën 25.03.2024, andaj, gjykata ka proceduar tutje komfor nenit 41 të LKA-së.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 10.06.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marr komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Mbesim në tërësi sipas përgjigjes në padi, thënieve të mëhershme të evidentuar në procesverbalin pranë kësaj gjykate, i propozojmë gjykatës që ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Ekspertizën financiare e kemi pranuar, të njëjtën sa i përket vlerës së rivlerësuar - diferencës për DUD-at kontestues ne e kemi dërguar edhe në Sektorin e vlerës në Doganë, ku edhe nga të njëjtit kemi pranuar vlerën e njëjtë të rivlerësimit sikurse eksperti në ekspertizë, një kopje të këtij komunikimi i'a dorëzoj edhe gjykatës. Nga administrimi i provave, e sidomos nga dëgjimi i ekspertit i cili edhe në ekspertizë dhe sot drejtpërdrejtë në seancë i cili u deklarua se nga pagesa ndërkombëtare në vlerë prej 180.511.90 USD, i njëjti edhe për kundër përpjekjeve për tre DUD - at kontestues nuk ka arritur të bëjë harmonizimin në tërësi të transaksionit bankar me DUD - at kontestues. Andaj nga kjo i propozojë gjykatës që ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 02.05.2024 ka administruar provat dhe atë: aktvendimin

01.03.2.2/18835;19106;19642;20418;20615 të datës 27.10.2021, kontratën nr.CF210329U-0260 të datës 29.03.2021, pro faturën nr.CF210329U-0260 të datës 29.03.2021, Urdhërpagesën Bankare Ndërkombëtare të datës 29.03.2021, faturën nr.2021-058, nr.CF210329U-0264-2 të datës 30.07.2021, nr.CF210329U-0264-1 të datës 30.07.2021, CF210421U-0325-1 të datës 12.07.2021, CF210329U-0264-3 të datës 03.08.2021, DUD-at 28157/29.09.2021, 28264/30.09.2021, 29411/09.10.2021, 30451/19.10.2021, 30800/21.10.2021, Urdhërpagesat Bankare së bashku me Pagesat Bankare të detyrimeve doganore, pecking list, përgjigjen në padi të datës 10.06.2022, deklaratën EXA, ankesat e ushtruara në Doganë, Proceset mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave, dosjen e vlerës, vendimin 17/36 të datës 22.09.2021, korrespondencën- emailin e datës 24.04.2024, 17.04.2024, së bashku me tabelën nr. të protokollit 6718/26.03.2024.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në ankesë, shkresave të lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestues fakti se subjekti në procedurë këtu paditësi “B.I Term” sh.p.k, me seli në Ferizaj, përmes DUD-ave R-28157/29.09.2021, R-28264/30.09.2021, R-29411/09.10.2021, R-30451/19.10.2021 dhe R-30800/21.10.2021 të ZBD Ferizaj, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor sipas dokumentacionit përcjellës të mallit. Nuk ishte kontestues as fakti tjetër se e paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga këtu paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes proceseve mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e 6 (gjashtë) të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-109, respektivisht në bazë të Dosjes së Vlerës ID1296, ID297, ID1298, ID1299, ID1300, ID1301, ID1302, ID1303, ID1307 dhe ID1308, si dhe i janë kontestuar shpenzimet e transportit në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.06/2015. Po ashtu, nuk është kontestues as fakti se paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës e për të cilën ankesë e paditura me datë 27.10.2021, ka sjell aktvendimin 01.03.2.2/18835;19106;19642;20418;20615, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në

procedurën administrative në shkallë të dytë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 08.12.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë, këtu paditësit për rishqyrtimin e Deklaratave Unike Doganore R-28157/29.09.2021, R-28264/30.09.2021, R-29411/09.10.2021, R-30451/19.10.2021 dhe R-30800/21.10.2021 të ZBD Ferizaj, dhe ka lënë në fuqi të njëjtat. Me arsyetim se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur për DUD-at e lartcekur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël sesa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDA-së. Tutje ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit lëndor kontestues është bazuar në metodën e 6-të të vlerësimit neni 35 i KDA-së, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, përkatësisht sipas dosjes së vlerës. Tutje ka theksuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka shtuar shpenzimet e transportit për DUD-at R-28264/30.09.2021, R-29411/09.10.2021, R-30451/19.10.2021 dhe R-30800/21.10.2021 të ZBD Ferizaj nga vendi dërgues, pasi që subjekti për R-28264/30.09.2021 ka rezultuar me kundërvajtje doganore, pasi që në dokumentin Bill of Lading nr.4352-0210-107021 është cekur pariteti “Freight Collect” ku do të thotë që shpenzimet e transportit i bartë pranuesi i mallit, pa këto dokumente janë në kundërshtim me faturën dhe kontratën, andaj, shpenzimet i janë shtuar bazuar në UA 06/2015 të ndryshuar dhe plotësuar me vendimin e Qeverisë 17/36 të datës 22.09.2021, i cili vendim ka ndryshuar/plotësuar vlerën e shpenzimeve të transportit detar dhe kontejnerëve në Shtojcën 2 të UA nr.05/2015 për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara konform listës së çmimeve të përditësuara si pjesë përbërëse e këtij vendimi. Tutje ka theksuar se kjo ka rezultuar pas hulumtimeve të bëra nga Sektori i Vlerës i Doganës së Kosovës dhe krahasimit të çmimeve, në veçanti për periudhën 2020/21 është evidentuar një ngritje e theksuar e kostos së shpenzimeve të transportit kryesisht nga Azia të determinuar nga faktor të ndryshëm ekonomik. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e aktvendimit të kontestuar të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me aktvendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje tregtare - administrative.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë në vështrim të nenit 44, parag. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas parag. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarës së palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.500/22 të datës 30.01.2024, ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontest tregtar administrativ me ekspertin financiar G.P., i cila ka pasur për detyrë që të konstatoj diferencën e mjeteve të paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të DUD-ave kontestues R-28157/29.09.2021, R-28264/30.09.2021, R-29411/09.10.2021, R-30451/19.10.2021 dhe R-30800/21.10.2021, veçmas për taksën doganore e veçmas për TVSH-në, harmonizimin e transaksioneve bankare ndërkombëtare në kuptim të vërtetimit të statutit të transaksionit bankar ndërkombëtar, harmonizimin e shumës së paguar me transaksion bankar ndërkombëtar në raport me vlerën si në faturë, kontratë dhe pro faturën nr. CF210329U-0260 për DUD-at kontestues dhe DUD-at eventual jo kontestues, dhe përshkrimin e përshkrimin e pagesës së bërë në transaksionet bankare ndërkombëtare në raport me numrat e faturave, kontratave dhe pro faturave sipas DUD-ave kontestues dhe jo kontestues.

Eksperti financiar në ekspertizën financiare të datës 05.03.2024, ka deklaruar se: *“Taksa doganore e paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të DUD-ave, për DUD-at kontestues është 10,497.04 €, ndërsa TVSH e paguar më tepër është 20,784.14 €”*, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se *“... për tre DUD-at kontestues 30800, 29411, dhe 28264 edhe pse kam gjet elemente që lidhen me kontratë, në disa pika dhe me pagese prapë se prapë vlerën e pagesës ndërkombëtare në shumë prej 180.511.90 USD nuk ka mundur ta harmonizojë në tërësi me faturat e DUD-ave kontestues dhe jo kontestues”*. Kurse në pyetjen e përfaqësuesit të paditurës se në faqen 4 të ekspertizës në paragrafin e fundit keni cekur pagesën ndërkombëtare në vlerë prej 180,511.90 USD, ndërsa si total të faturave që ndërlidhen me këtë pagesë keni cekur shumën prej 93,647.13 USD, a keni mundur ta vërtetoni se pjesa tjetër për tej kësaj shume prej 93.647.13 USD , është importuar apo është zhdoganuar me ndonjë DUD tjetër, eksperti ka deklaruar se *“Sipas shkresave në dosjen e lëndës dhe atyre që kam pranuar nga pala paditëse, nuk kam*

mundur të gjejë asnjë DUD apo faturë tjetër për të bërë barazimin dhe përmbylljen me shumën sikurse në pagesën bankare, në kontratën dhe pro faturën përkatëse”.

Gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i'a dha besimin e plotë sqarimeve të ekspertit si në seancë lidhur me ekspertizën financiare, ngase e njëjta së bashku me sqarimet e dhëna i përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale, dhe ka arsyetime të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoj si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë kontest tregtar administrativ, si dhe është në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm.

Gjykata vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit se Sektori i Pranimit Qendror nuk i ka vlerësuar drejtë provat e prezantuara në Deklaratën Unike Doganore në vështrim të nenit 33 të KDA-së, të cilat kërkohen në vështrim të nenit 123 të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave, ngase të gjitha janë të harmonizuara në kuptim të vlerës, ngase i njëjti është në kundërshtim me pretendimin e të paditurës se në rastin konkret nuk mund të veprohet sipas kërkesës së subjektit ankimor që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar, pasi që subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të besueshëm dhe të kompletuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmim real i paguar për mallin lëndor kontestues, dhe në rastin konkret vlera e deklaruar nuk do të pranohet si vlerë reale e paguar për mallin lëndor kontestues, gjithmonë duke pasur parasysh se nuk është e mjaftueshme që në kundërshtim të paraqiten pretendime të caktuara por është obligim i subjektit ankimor që komfor Ligjit të Procedurës Administrative pretendimet e tij të dëshmojë me prova të besueshme të cilat provojnë qartë me dokumentacion të kompletuar dhe origjinal të harmonizuar për vlerën reale të mallit të paguar ose të pagueshëm për mallin lëndor, e të cilin konstatim faktik dhe qëndrim juridik të bërë nga Dogana e Kosovës, gjykata e pranon si të drejtë. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar Gjykatës provat materiale si pro faturën, faturat e mallit, dhe transaksionin bankar ndërkombëtar, i njëjti nuk ka arrit të dëshmojë vlerën reale të paguar për mallin lëndor, ngase sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret faturat e DUD-ave kontestues nuk përputhen me pagesën bankare ndërkombëtare, dhe nuk përputhen as me kontratën dhe pro faturat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të cilin fakt e ka konstatuar edhe eksperti në ekspertizën financiare të lartcekur dhe në seancën e shqyrtimit kryesor. Prandaj, nga kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në vijim Gjykata, lidhur me pretendimin e paditësit se në momentin e zhdoganimit të mallit kemi prezantuar të gjitha dokumentet në origjinal, ashtu siç e parasheh Kodi Doganor dhe i Akcizave

të Kosovës, vlerëson se përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7 Par.1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ”* Nga këto dispozita Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38 par. 2 të LKA-së, Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtroj faktet në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte, të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të lartcekura të paditësit, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë kontest tregtar administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtetë paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata thekson se në nenin 33 par.1 të KDAK-së është parashikuar se: *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, ndërsa në nenin 34 par.1 të KDAK-së parashihet që “Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit; Vetëm në rast kur vlera nuk mund të përcaktohet në bazë të një nën-paragrafi të caktuar, lejohet të aplikohen dispozitat e nën-paragrafit që vjen me radhë menjëherë pas tij”.* Nga këto dispozita ligjore, Gjykata konstaton se e paditura në rastin konkret,

ka vepruar në mënyrë të drejtë kur ka rivlerësuar mallin e importuara nga paditësi, duke dhënë arsytim të mjaftueshëm se përse vlerësimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë siç parashihet me ligj, pasi që paditësi rezulton të ketë dorëzuar dokumentacionin jo të harmonizuar, e të kërkuar ligjërisht dhe kështu ka dështuar të provojë edhe vlerën e transaksionit për mallin e kontestuar, si dhe çmimin vërtet të paguar, siç përcaktohet me nenin 33 par.1 të KDAK-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, paragraf 1, dhe nenit 46, paragraf 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.500/22 datë 02.05.2024

Zyrtare Ligjore
Amire Jahiri

G j y q t a r i,
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.